



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 890/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtaret Muhamet Rexha kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ergul Morina nga subjektit politik KTB nga Mamusha, paraqitur për shkak të parregullsive gjatë ditës së zgjedhjeve për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e pa afatshme ankesa e Ergul Morina nga subjekti politik KTB

Arsyetim

PZAP-i, me datën 15.11.2013 ka pranuar një ankesë nga Ergul Morina nga subjekti politik KTB, në të cilën kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në Mamushë për shkak se në ditën e zgjedhjeve janë bërë disa parregullsi në vendvotime dhe se parashtresuesi i ankesës në cilësinë e komisionarit nuk e ka nënshkruar librin përfundimtar dhe se në vend të tij e ka nënshkruar një person tjetër.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa afatshme

PZAP-i, konstatoi se ankesa është e pa afatshme ngase afati për të parashtruar ankesë në PZAP është përcaktuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur ligjore për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”*. Ndërsa ankesa në fjalë është parashtruar në PZAP me datë 15.11.2013, që nënkupton se është pas afatit të përcaktuar sipas dispozitës së sipërsënuar, andaj duke u bazuar në nenin 119.1 të LZP-së dhe nenin 4.2 të Rregullave dhe procedurave të PZAP-it u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 890/2013 më datën 18.11.2013

**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**



Këshillë juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.